

Raporti individual i konsultimit publik

1. **Titulli i projekt aktit:** “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2021 “Për të huajt””

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projekt akti synon të përmirësojë fushën e të drejtave të migrantëve dhe anëtarëve të tyre të familjes, refugjatëve dhe azilkërkuesve, si dhe të mbrojtjes sociale (akses në programe dhe shërbime integrimi), ofrimit më të mirë të informacionit, procedurave të lehtësuara dhe forcimit institucional të ofrimit të shërbimeve për migrantët.

Hartimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.79/2021 “Për të huajt”” vjen si nevojë dhe detyrim i rishikimit të rregullt të ndikimit të akteve ligjore, në mirëqeverisjen e migracionit. Projekt akti i hartuar është bazuar edhe në nevojat dhe problematikat kombëtare, të evidentuara sipas fushës së përgjegjësisë për çdo institucion.

Në vijim të sa më lart, projekt akti është publikuar për konsultim në RENJKP përgjatë periudhës 4 shtator 2024 deri në 2 tetor 2024.

Projekti i publikuar në RENJKP, pati 481 lexime dhe 0 komente në platformë, por UNHCR dhe IOM kanë dërguar komente në e-mailin e koordinatorit për konsultim publik dhe personave përgjegjës për hartimin e aktit.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Për të siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe transparent në hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2021 “Për të huajt””, janë përdorur katër metoda të ndryshme konsultimi. Më poshtë gjeni një përshkrim të detajuar për secilën nga këto metoda:

1. Përdorimi i Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet Publike prej datës 4 shtator 2024 deri në 2 tetor 2024, si një mënyrë e cila lejon qytetarët dhe palët e interesuara të paraqesin komente dhe sugjerime në lidhje me projekt aktin përmes internetit, duke siguruar akses të gjerë dhe transparencë në procesin e konsultimit;
2. Takime me grupin e punës në zbatim të urdhrin të Grupit Ndërinstitucional të Punës i ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr.114, datë 16.7.2024 “Për ngritjen dhe funksionimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.79/2021, “Për të huajt””. Këto takime përfshijnë mbledhje të grupit të punës të ngritur posaçërisht për hartimin e projekt aktit dhe diskutime të detajuara mbi politikat e propozuara.
3. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike), si formë për të komunikuar me individë dhe organizata të interesuara në lidhje me projekt aktin, por gjithashtu edhe për shkëmbime të dokumenteve dhe komenteve midis anëtarëve të grupit të punës dhe titullarëve të institucionit;
4. Takime dhe tryeza teknike me përfaqësues të Delegacionit BE dhe ekspertët e IOM.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

- Drejtoria e Politikave për Antitrafikun dhe Migracionin;
- Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Çështjet e Brendshme në MB;
- Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MB;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Ekspertët e organizatave ndërkombëtare;
- Koordinatorin për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJKP.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
---	--	---	---	-------------

për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	çështjen në mënyrë të ngjashme)		
Neni 3 i projektligjit	Sjelljen e përcaktimit të një personi pa shtet në nenin 3, të projektligjit në përputhje me përcaktimin ligjor ndërkombëtar të një personi pa shtet, duke inkorporuar elementin e "nën funksionimin e ligjit"	UNHCR	Pranuar	Reflektuar në draft
Neni 3, pika 31 e projektligjit	Duke pasur parasysh se lista nuk është shteruese, UNHCR rekomandon që neni 3, pika 31, të ndryshohet, duke shtuar kategori të tjera të personave të pambrojtur, përfshirë viktimat e trafikimit njerëzor, personat me sëmundje të rënda, personat me çrregullime mendore dhe individët lesbike, gej, biseksualë, transgjjinorë dhe	UNHCR	Pranuar	Reflektuar në draft

	interseks (LGBTI);			
Koment i përgjithshëm	Autoritetet përkatëse të sqarojnë në këtë projekt-ligj procedurat e kërkuara në lidhje me lëshimin e dokumenteve të udhëtimit për personat pa shtetësi kur udhëtojnë jashtë vendit;	UNHCR	Nuk pranohet	Sugjerimi nuk pranohet pasi, në përputhje me teknikën legjislative, procedurat miratohen me akte nënligjore. Gjithashtu, kjo është rregulluar edhe me nenin 4, të këtij projektligji.
Koment i përgjithshëm	Sqarimin e procedurës për marrjen e dokumenteve zëvendësuese kur këto dokumente humbasin ose dëmtohen;	UNHCR	Nuk pranohet	Sugjerimi nuk pranohet pasi, në përputhje me teknikën legjislative, kjo procedurë është e rregulluar me akt nënligjor.
Koment i përgjithshëm	Kur paraburgimi zbatohet për të huajt, atyre do t'u sigurohen masat mbrojtëse d.m.th., aksesit në informacion në një gjuhë që ata kuptojnë, informacion mbi arsyet ligjore dhe faktike të paraburgimit, zgjidhjet e mundshme, aksesit në procedurat e azilit nëse është e nevojshme.	UNHCR	Nuk pranohet	Lidhur me këtë koment sqarojmë se, të gjithë hapat që ndërmerren për migrantët dhe azilkërkuarët, si dhe të drejtat e tyre, janë të parashikuara dhe respektohen në përputhje me ligjet e tyre respektive.

Komente mbi nenet 54 dhe 119 të projektligjit	UNHCR rekomandon që dispozitat për ndalimin e fëmijëve të pashoqëruar të hiqen dhe teksti i neneve 54,(1) dhe (2), duke ndryshuar nenin 119 të ligjit 79/2021, të rishikohet për të përcaktuar se fëmijët nuk duhet të mbahen në paraburgim dhe në ligj të futen rregullimet e duhura të kujdesit dhe programet e bazuara në komunitet	UNHCR	Nuk pranohet	Lidhur me këtë koment sqarojmë se në mënyrë përfundimtare, është parashikuar që i mituri i pashoqëruar i ndaluar, të mbahet në një qendër për të mitur, e hapur posaçërisht për këtë qëllim, në ambiente apo qendra të tjera, që janë hapur apo funksionojnë në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare dhe organizata jofitimprurëse që kryejnë misione për fëmijët ose kategori të tjera individësh që janë në nevojë.
Koment i përgjithshëm	Në komentet e saj IOM sugjeron rishikimin e disa termave të përdorur në projektligj. Por këto keqkuptime kanë ardhur si pasojë e përkthimit të draftit nga shqipja në anglisht, si psh: termi “alien”, “minors” apo “vulnerable persons”.	IOM	Pranuar	Në terminologjinë e projektligjit apo dhe të ligjit bazë, përdoret termi “i huaj” si qënie humane, termi “fëmijë” në përputhje me ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

Koment i përgjithshëm	Të shtohet në kategorinë e personave vulnerabël edhe kategoria e viktimave të trafikimit. A kanë të drejtë të pajisen me lejeqëndrimi?	IOM	Pranuar	Lidhur me komentet për pajisjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit me leje qëndrimi, sqarojmë se kjo është e parashikuar dhe rregullohet me nenin 53, të ligjit nr.79/2021 “Për të huajt”.
Koment mbi nenin 51 të projektligjit	Në nenin 51 të projektligjit, sugjerohet të citohen masat alternative.	IOM	Pranuar	Sugjerimi është tashmë i reflektuar në ligjin “Për të Huajt”. Për sa i përket listës së masave alternative, ligji për të huajt parashikon të gjitha hapat administrative që ndërmerren nga autoritetet kompetente deri na marrjen e masës së fundit të mbylljes në qendër. Masat alternative caktohen rast pas rasti, të tilla si: neni 113- ndalimi në një territor të caktuar, neni 110 - detyrim për paraqitje apo neni 109 – që flet për ekzekutimin e masave të përkohshme.
Koment mbi nenin 54 të projektligjit	Për nenin 54 të projektligjit sugjerohet që i mituri nuk mund	IOM	Pranuar	Reflektuar në draft

	të mbyllet në një qendër.			
--	------------------------------	--	--	--